



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni Pranveror

**Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport,
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 02.

Prishtinë, më 21.03.2011 ora 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N – 303.

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike,
Qeverisje Lokale dhe Media**

Në mbledhje morën pjesë : Idriz Vehapi - kryetar, Enis Kervan, Ramë Vataj, Xhevahire Izmaqi, Lirije Kajtazi, Sadri Ferati, Afrim Kasolli, Teuta Haxhiu, Jeton Svirca dhe Vesimir Savič.

Mungoi: Eqrem Kryeziu.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Lule Ymeri, Drita Morina, Shaip Goxhuli dhe Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësues të OSBE-së, KDI-së, të Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore.

Mbledhjen e kryesoi Idriz Vehapi , kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve për Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave;
3. Shqyrtimi i listës së Komisionit të Pavarur për Media, me emrat e kandidatëve të propozuar për anëtarë të Këshillit për Komisionin e Pavarur për Media;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010;
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore për periudhën mars 2009 – dhjetor 2010.
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve për Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave;

Kryetari - njoftoi anëtarët e Komisionit, se Qeveria e Kosovës ka sjellë vendimin për formimin e Komisionit Qendror për regjistrimin e popullsisë, konform nenit 22 të ligjit për regjistrimin e popullsisë. Kryesia e Kuvendit ka shqyrtuar vendimin dhe ka nxjerr përfundim me të cilin e ka ngarkuar komisionin funksional të shqyrtojë vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Gjithashtu, ai e njoftoi Komisionin se Qeveria ka sjellë propozimin për ndryshimin e një anëtari të Komisionit Qendror, konform nenit 12.5 të ligjit për regjistrimin e popullsisë.

Jeton Svirca – propozoi, që komisioni ta miratojë propozim – vendimin e Qeverisë.

Sadri Ferati – përkrahu diskutimin për miratimin e propozim – vendimit të Qeverisë dhe tha se nuk ka ndonjë kërkesë lidhur me këtë.

Duke pasur parasysh se emërimi i kontrollorëve në komisionet për regjistrimin e popullsisë është total mbi baza politike dhe sipas informacioneve që kemi se sfida më e madhe në administratën shtetërore dhe lokale është politizimi, propozimi i tij ishte që në njërin nga mbledhjet e radhës të diskutohet, për të ngritur përshtypjen, që të instalojmë institucione të cilat në rend të parë e kanë në interes procesin të cilin e udhëheqin dhe që të gjithë qytetarët ti trajtojnë njëjtë, në mënyrë që qytetarët ta kenë mundësinë e barabartë gjatë konkurrimit dhe jo gjithmonë të kenë parasysh se cila do të jetë vija mbi baza familjare apo partiake.

Ramë Vataj – ai përkrahu diskutimin e parafolësve lidhur me miratimin e vendimit, duke propozuar një mbikëqyrje më të mirë të komisionarëve të komisioneve për regjistrimin e popullsisë, sepse një gabim i tyre p.sh. një zero me pak apo më shumë mund të kushtojë.

Teuta Haxhiu – ajo tha, se komisionarët duhet të jenë të zgjedhur profesionalisht, vlerësimi i tyre nuk është bërë nga komunat, por ata janë të caktuar nga niveli qendror.

Kryetari – kërkoi nga anëtarët e komisionit që kjo pikë e rendit të ditës të miratohet dhe të procedohet më tutje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me 10 vota “për”, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. I Rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë Propozim - Vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve për Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave me këtë ndryshim si vijon:

II. Të zëvendësohet, Nait Vrenezi, anëtar nga Enti i Statistikave të Kosovës me Ibrahim Shabani – Kryeshef i Entit të Statistikave të Kosovës.

Arsyetim:

Komisioni gjatë shqyrtimit të Propozim – Vendimit të Qeverisë lidhur me emërimin e anëtarëve për Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave ka shqyrtuar edhe propozimin e Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Administratës Publike për zëvendësimin e z.Nait Vrenezi, anëtar i Komisionit Qendror të Regjistrimit, përfaqësues nga Enti i Statistikave të Kosovës, me z. Ibrahim Shabani.

Meqë, Nait Vrenezi ka dhënë dorëheqje nga Enti i Statistikave të Kosovës, Ministria e Administratës Publike konform nenit 12.5 të Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave ka propozuar anëtarin e ri z. Ibrahim Shabani, Kryeshef i Entit të Statistikave të Kosovës.

3. Shqyrtimi i listës së Komisionit të Pavarur për Media, me emrat e kandidatëve të propozuar për anëtarë të Këshillit për Komisionin e Pavarur për Media;

Kryetari – e njoftoi Komisionin për procedurat e emërimit të anëtarëve Këshillit të KPM-së, të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës, sipas ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, nr. 02/L- 15.

Ai, gjithashtu i njoftoi anëtarët e komisionit, që komisioni në kuadër të fushëveprimtarisë së vet nuk e bënë përzgjedhjen e anëtarëve, por vetëm i rekomandon Kuvendit iniciimin e procedurës për formimin e Komisionit ad –hoc, konform nenit 4.4 e) të ligjit për KPM-ne dhe nenit 71 të Rregullores së Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010;

Kryetari – e njoftoi Komisionin që KPM-ja në bazë të nenit 3.8 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media i raporton Kuvendit të Kosovës me raport vjetor brenda dy muajve pas përfundimit të çdo viti kalendarik.

Ai tha se raporti është i hartuar sipas formës së duhur që kërkohet për tu hartuar një raport nga një institucion, përfshirë këtu edhe shtojcat shtesë të raportit.

Sadri Ferati – duke hezituar që raportin ta përkrah, ai tha që raporti të shikohet nga këndi se sa mund të mësohet nga një raport pune, në mënyrë që pastaj komisioni ta bëjë një plan të punës, e jo për të vlerësuar kolegjet se si kanë punuar në mandatin e kaluar.

Gjatë hartimit të planit të punës do të diskutojmë për të shikuar se sa mund të begatojmë nga një përvojë e kaluar, një ambicie, mbi baza të një plani të punës që do ta kemi.

Kryetari – kërkoi nga anëtarët e komisionit që kjo pikë e rendit të ditës të miratohet dhe të procedohet më tutje, pasi që nuk pati vërejtje të tjera nga anëtarët e komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me 10 vota “për”, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I Rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010.

Arsyetim

Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur të Mediave i vitit 2010 është i kompletuar dhe i përmbahet të gjitha kritereve të hartimit të një raporti. Raporti i KPM-së tregon një performancë të mirë, që është për t'u vlerësuar.

5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore për Periudhën mars 2009 – dhjetor 2010.

Me kërkesën e anëtarëve të Komisionit dhe arsyetimin që shqyrtimi i raportit të Këshillit nuk ishte një çështje urgjente, Komisioni unanimisht vendosi që kjo pikë të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Idriz Vehapi**
